

Studim politikash: —————>

PARIMET E RIMËKËMBJES SË GJELBËR PËR KOSOVËN – MËSIMET NGA PAKOT PARAPRAKE DHE RRUGA PËR RIMËKËMBJE TË QËNDRUESHME



Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Qeverisja Demokratike

Publikuar: Janar 2022

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” do të monitorojë implementimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Në të njejtën kohë, do të informojë qytetarët mbi përfitimet e kësaj pakoje, e po ashtu do të analizojë qëllimet dhe pritjet nga masat që përfshin Pako e Ringjalljes Ekonomike. Ky projekt është i mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund e Sh.B.A.- së dhe USAID.

Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia	6
1. Rimëkëmbja e gabuar dhe mungesa e parimeve për caktimin e masave	7
2. Parimet e rimëkëmbjes së gjelbër – mësimet nga vendet tjera	14
2.1. Parimi i reduktimit të konsumit dhe optimizimit të shpenzimit	15
2.2. Parimi i transformimit të infrastrukturës	16
2.3. Parimi i integritimit	17
3. Studim krahasimor rastet e Gjermanisë, Norvegjisë, Luksemburgut dhe Bashkimit Europian	18
4. Kornizë e opsioneve politike për rimëkëmbje të gjelbër	21
4.1. Masat për eficiencën e energjisë	22
4.2. Transformimi i gjenerimit të energjisë përmes rimëkëmbjes	23
4.3. Masat për tregun dhe integrimin e tregut	24
Përfundime	26
Rekomandime	28

Hyrje

Dëmet e shfaqura si pasojë e pandemisë COVID-19 po vazhdojnë të jenë prezente në vendin tonë. Këto dëme që janë paraqitur në aspektin social, shëndetësor dhe ekonomik po ndikojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm, jo vetëm të Kosovës por edhe në atë global. Këto dëme kanë ndikuar negativisht në shumë procese ekonomike zingjirë të cilat ndikojnë në zhvillimin e një vendi, e gjithashtu kanë prekur dhe dëmtuar shumë persona të cilat janë pjesë e këtij zingjiri.

Tentimi i tejkalimit të krizës pandemike përmes pakove ekonomike ka lehtësuar dhe shpejtuar procesin e rimëkëmbjes, por këto pako nuk kanë shuar tërësisht dëmet dhe vështirësitë për qytetarët e Kosovës. Pako e Ringjalljes Ekonomike është pako e katërt e miratuar nga Qeveria e Kosovës për të ndihmuar qytetarët e vendit tonë.¹ Përfshirja e shumë sektorëve në këtë pako nuk nënkupton zgjidhjen e problemeve dhe rrjedhimisht nuk siguron një rimëkëmbje të qëndrueshme për të ardhmen.

Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës është goditur në mënyrë drastike nga pandemia. Humbja e vendeve të punës, rrezikimi i punëtorëve, ndërprerja e aktiviteteve ekonomike dhe mbylljet si rrjedhojë e parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 janë disa nga shkaktarët që Bruto Produkti Vendor (BPV) të goditet dhe të dëmtohet.² Duke pasur parasysh këtë, zgjidhje afatgjate dhe e qëndrueshme, e në të njëjtën kohë zgjidhje e cila ofron një rimëkëmbje nga pandemia mbetet integrimi i politikave të gjelbërta.

Pavarësisht shpresave fillestare se ekonomia e Kosovës do të rikthehet më shpejtë nga mbyllja e shkaktuar nga koronavirusi, tani po bëhet e qartë se çdo rimëkëmbje do të jetë një çështje shumë më e ngadaltë. Megjithatë, nuk është gjithçka fatkeqësi dhe erësirë. Situata aktuale i ofron Qeverisë së Kosovës një mundësi unike për të rikthyer ekonominë kosovare në një mënyrë që i jep përparësi zgjidhjeve përmes politikave me karbon të ulët, që janë miqësore me mjedisin dhe që trajtojnë ndryshimet klimatike. Por duke u bazuar në pakot paraprake dhe në pakon aktuale që tani më po implementohet, një mundësi e tillë nuk është duke u shfrytëzuar nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Pakot paraprake dhe pako aktuale e Qeverisë së Kosovës, të cilat kanë për qëllim adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19, nuk janë fokusuar në ofrimin e një rimëkëmbjeje të gjelbër ekonomike. Një rimëkëmbje e gjelbër do të fokusohet në politikën dhe zgjidhjet që trajtojnë problemet klimatike dhe padrejtësinë ekonomike dhe sociale. Duke miratuar politika të ekonomisë së gjelbër, vendet si Kosova mund të hapin rrugë për një rimëkëmbje ekonomike dhe vende pune të qëndrueshme bazuar në modele biznesi të kujdesshme ndaj mjedisit.

Pako e Ringjalljes Ekonomike nuk ka marrë parasysh as kriteret e paracaktuara për rimëkëmbjen e gjelbër. Nuk ka pasur as kriteret e kost-reflektimit nga pandemia, e as kriteret e transformimit të sistemit energ-

¹ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A-6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>, (qasur në janar, 2022)

² Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/add-news/bruto-produkti-vendor-bpv-me-qasjen-e-shpenzimeve-dhe-t%C3%AB-prodhimit-tm3-2020/>, (qasur në janar, 2020)

jetik dhe përmirësimit mjedisor. Këto kritere do të mund të përdoren për të rritur efektshmërinë dhe ndikimin e pakos së ringjalljes por edhe për të shfrytëzuar këto momentume për të ndihmuar tranzicionin e energjisë dhe dekarbonizimin.

Energjia elektrike e gjeneruar nga burimet e ripërtërishme është e ardhmja e pashmangshme dhe e duhur e sektorit të energjisë elektrike në tërë globin. Energjia e ripërtërishme është zgjedhja e pashmangshme për rritjen e qëndrueshme ekonomike, për bashkëjetesën harmonike të njerëzve dhe mjedisit si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm. Në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, e cila ka të integruara 420 milionë Euro, është paraparë shuma prej 100 milionë Eurove për Masën 5 – Investime në infrastrukturë dhe ambient. Shumica e masave të kësaj pakoje përqendrohen në kujdesin shëndetësor dhe mbështetjen financiare për bizneset dhe rritjen e skemave sociale për qytetarët të prekur më së shumti nga pandemia. Por gjithashtu kjo pako ka lënë hapësirë edhe për investimet në sektorin energjetik të gjelbër. Duhet të ceket se kjo masë ende nuk ka filluar të implementohet dhe rrjedhimisht ende nuk ka treguar efekt të ndikimit në sektorin energjetik të Kosovës.

Temë trajtimi në këtë punim është rimëkëmbja e gjelbër. Sfidat, mundësitë, benefitet dhe problematikat janë disa nga pikat në të cilat fokusohet punimi. Duke shtjelluar qëllimet, pritjet dhe mundësitë e rimëkëmbjes së gjelbër, synojmë që të nxjerrim përfundime konkrete mbi kualitetin dhe rëndësinë e kësaj forme të rimëkëmbjes. Gjithashtu,

duke shfrytëzuar mësimet e nxjerra, ne synojmë që rekomandimet të shërbejnë si bazë për dizajnimin e pakove të reja në mënyrë që të jenë më të zbatueshme, më efikase dhe me fokus tek politikatat e gjelbërta.

Metodologjia

Për hartimin e këtij punimi është përdorur metodologji e përzier, kualitative dhe kuantitative. Në pjesën ku është përdorur hulumtimi kuantitativ, INDEP përmes metodës së monitorimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata rreth hapave të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Duke filluar me hulumtimin në tavolinë, kjo metodë kontribuoi në mbledhjen e të dhënave në shkallë globale, por edhe për sfondin e Kosovës në aspektin e rimëkëmbjes pandemike. Në këtë proces u përcaktuan sfidat, prolemet dhe mundësitë e avansimit të politikave që hapin udhë për arritjen e një transformimi energjetik, rimëkëmbje nga pandemia dhe krijimin e një zvhllimi të qëndrueshëm në të ardhmen. Shqyrtimi i literaturës jep dëshmi dhe raste studimore të shteteve të tjera që kanë pasur sukses në arritjen e rimëkëmbjes së gjelbër.

Krahas kësaj në mënyrë që ky punim të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave kuantitative edhe përmes hulumtimit kualitativ. Më specifikisht, metodat e përzgjedhura për hartimin e këtij punimi janë studimet e rasteve, mbledhja e të dhënave dhe raportimi i hulumtimeve të INDEP. Studimet e rasteve të cilat kanë përdorur pakot financiare dhe politikat e gjelbërta për rimëkëmbje janë të fokusuara tek Gjermania, Norvegjia, Luksemburgu dhe Bashkimi European.

Punimi është realizuar në kornizën e procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Punimi ka për qëllim të ofrojë zgjidhje dhe politika të cilat mundësojnë tejkalimin e krizës dhe vështirësive të shkaktuara nga pandemia COVID-19, në mënyrë që të arrihet zhvillim ekonomik i mëtutjeshëm, krijim i vendeve të reja të punës, të ndihmohet tranzicioni energjetik dhe të mundësojmë impakt pozitiv në mjedis për gjeneratat aktuale dhe ato pasardhëse. Përmes monitorimit të implementimit të kësaj pako dhe mbledhjes së të dhënave në kuadër të pakos, INDEP synon të informojë qytetarët, të ngrisë nivelin e transparencës dhe gjithashtu të ngrisë nivelin e llogaridhënies.

1. Rimëkëmbja e gabuar dhe mungesa e parimeve për caktimin e masave

Pandemia COVID-19 është një nga sfidat më të vështira të globit gjatë dekadave të fundit. Rrezikimi i shëndetit, rrezikimi nga humbja e vendit të punës, goditja e rëndë në ekonomi dhe vështirësitë e tjera që preken secilin shtet, ishin disa nga problematikat kryesore që erdhën së bashku me pandeminë. Këto problematika sjellën pasojë për të cilat nevojitet kohë e gjatë që të adresohen dhe të kthehen në normalitetin që mbizotëronte në botë para pandemisë. Andaj kosto e pandemisë, ani pse ende nuk është e saktë në asnjë fushë të jetesës, ka prekur dhe dëmtuar rëndë secilin shtet, por në veçanti vendet e pazhvilluar dhe ato në zhvillim siç është Kosova.

Bilanci përfundimtar në ekonomi, në numrin e vdekjeve dhe në mirëqenien sociale është ende herët për t'u shpalosur. Për adresimin e këtyre problemeve janë hartuar, miratuar dhe implementuar disa pako të ndihmave nga ana e Qeverisë së Kosovës. Që nga konfirmimi i rasteve të para në vendin tonë, e deri më sot janë dizajnuar katër pako të ndihmave, përmes të cilave është synuar të adresohen problemet kryesore të familjeve kosovare.³ Këto pako kanë filluar me pakon emergjente fiskale e deri në pakon e fundit, Pakon e Ringjalljes Ekonomike, e cila për nga volumi i të hollave të alokuara është më e madhja.

Pakot e ndihmave të implementuara në vendin tonë kishin për synim adresimin dhe zgjidhjen sa më të mirë të problematikave të paraqitura nga shfaqja e pandemisë e deri më tani. Por përpos kësaj, pakot e mëparshme por edhe pako aktuale kanë të përbashkët një gjë, e cila është vetëm mbulimi i disa hallkave të hapura nga pandemia, e jo avansimi dhe rimëkëmbja e gjelbërt dhe e qëndrueshme për të ardhmen. Kjo si pasojë e mungesës së parimeve për caktimin e masave të cilat do të ndihmonin në krijimin e vendeve të reja të punës, ndikimin në tranzicionin energjetik dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Nga pikëpamja ekonomike, para së gjithash, pakot e ndihmave të rimëkëmbjes duhet të fokusohen në rikthimin e prodhimit dhe punësimit në nivele të qëndrueshme dhe afatgjate. Mbyllja e hendekut të prodhimit dhe krijimi i vendeve të punës në mënyrë që papunësia të zvogëlohet duhet të jenë disa nga qëllimet kryesore të Qeverisë së Kosovës. Edhe pse disa e kanë përdorur gabimisht analogjinë, tejkalimi i krizave pandemike nuk është një përpjekje për rindërtim lufte. Kapitali fizik nuk është shkatërruar dhe prioriteti tani është ta vëmë në lëvizje përsëri avansimin ekonomik të shtetit. Ndalimi i kufizimeve të shëndetit publik, lejimi i firmave të operojnë, punëtorët të kthehen në punët e tyre dhe motivimi i konsumatorëve për të blerë përsëri janë sfidat kryesore afatshkurtra.

Një metodologji e tillë e përdorur nga ana e Qeverisë së Kosovës përmes pakove të miratuara nga ana e saj është tentim i tejkalimit të problemeve aktuale dhe jo strategji afatgjate. Proble-

³ INDEP, Ringjallja përmes kredive – Pritjet dhe Arritjet e masës së dytë të Pakos së Ringjalljes, e qasshme në <https://indep.info/ringjallja-permes-kredive-pritjet-dhe-arritjet-e-mases-se-dyte-te-pakos-se-ringjalljes/>, (qasur në janar, 2022)

met e tilla kërkojnë zgjidhje të cilat do të mbulojnë hallka edhe më të mëdha dhe probleme të cilat nuk janë të paraqitura vetëm nga pandemia COVID-19. Rimëkëmbja e tillë është e gabuar dhe rrjedhimisht e paqëndrueshme në aspekte kohore afatgjate. Prandaj fokusi kryesor duhet të jetë në tranzicionin energjetik, krijimin e vendeve të reja të punës dhe në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, në mënyrë që tejkalimi i pandemisë të arrihet përmes sigurimit të një rimëkëmbje afatgjate edhe për krizat e tjera eventuale në të ardhmen.

Por një përgjigje e Qeverisë së Kosovës përmes pakove të deri më tashme e të cilat fokusohen vetëm në aspektet e problemeve aktuale, normalisht se do të jetë dritëshkurtër. Paket e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19 duhet të përfshijë disa qëllime strukturore, në mënyrë që nëse ajo e cila synohet, është të ndërtohet më mirë në raport me para pandeminë. Një aspekt është promovimi i një rikuperimi më të qëndrueshëm duke siguruar, për shembull, se burimet e energjisë elektrike do të fokusohen në burime miqësore me ambientin. Më gjerësisht, disa nga pjesët kryesore dhe baza e projektimit të pakove të ndihmave duhet të fokusohen në rikuperimin më të gjelbër dhe të bazuar në natyrë dhe mbrojtjen e saj, pra më pak intensiv në aspektin e emetimit të karbonit dhe që kujdeset për ndryshimet klimatike aktuale dhe ato të së ardhmes.

Një nga parimet kryesore edhe para pandemisë ka qenë reduktimi apo zhdukja e varfërisë dhe pabarazisë. Përmes krijimit të vendeve të punës që kanë perspektivë për të ardhmen, ndihmohet në mënyrë të konsiderueshme një gjë e tillë. Tranzicioni energjetik, pra kalimi nga burimet fosile në burime të ripërtërishme të energjisë elektrike është proces afatgjatë dhe i cili kërkon bazë punëtore të shtuar për të arritjen e qëllimit të tij. Si një proces i pashmangshëm dhe me rëndësi të lartë për vendin tonë, edhe pakot paraprake por edhe Pako e Ringjalljes Ekonomike do të duhej të kishin në strukturimin e saj një parim të tillë, pra parimin e rimëkëmbjes së gjelbër.

Duke filluar nga Pako Emergjente Fiskale,⁴ si pako e parë për të adresuar problemet dhe për të tejkaluar krizën e pandemisë COVID-19, vërehet se është pako vetëm për zgjidhje të problemeve afatshkurtra. Masat e kësaj pakoje tregojnë qëllimin e adresimit të problemeve financiare për disa muaj. Një qasje e tillë e rimëkëmbjes paraqet zgjidhje të gabuar pasi që zgjidhja për rimëkëmbjen nga pandemia duhet të përmbajë krijim të vendeve të reja të punës, politika të reja për inkuadrimin e investitorëve të huaj në vendin tonë dhe kalimin nga energjia e dëmshme për shëndetin në energjinë e pastër, të gjelbër dhe të qëndrueshme.

⁴ Ministria e Financave dhe Transfereve, Pako Emergjente Fiskale, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8810F09D-B3C7-4E09-9BD1-0E2B0B2AF5CB.pdf>, (qasur në janar, 2022)

Pako Emergjente Fiskale (165 milionë Euro)

Përfitimi

Masa 1	Shumën e dyfishtë të asistencës sociale të zakonshme
Masa 2	Shtesën 30€ më shumë se asistenca sociale apo pensioni i zakonshëm
Masa 3	Mbulimin e shpenzimeve të pagave mujore të punëtorëve (dhe të vetë-punësuarit për bizneset individuale) në vlerë prej 170€ Subvencionimi i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për mikro-ndërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
Masa 4	Huadhënie pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre
Masa 5	Mbështetje shtesë financiare për Komunitetet e Republikës së Kosovës
Masa 6	Shtesë mbi pagë në vlerë prej 300 € për punëtorët në terren që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në vendin e tyre të punës
Masa 7	Pagesën shtesë me vlerë 100€
Masa 8	Pagesë në vlerë 130€
Masa 9	Mbështetje financiare për realizim të iniciativës ose projektit

Masa 10	<p>Për mikro-ndërmarrjet dhe të vetëpunësuarit, sigurimi i garancionit për likuiditetin financiar (hua) përmes programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) në shumë deri në 10,000€ për periudhën 24 muaj.</p> <p>Për shoqëritë Tregtare dhe Kompanitë e autorizuar që ofrojnë shërbime të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike, garanci nga FKGK deri në 50% të shumës së kredituar, kurse nga Qeveria e Kosovës mbulim shtesë i garancisë deri në 30% të shumës së kredituar mbi shumën e garantuar nga FKGK.</p>
Masa 11	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor
Masa 12	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore
Masa 13	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore
Masa 14	Pagesë prej 130€ për punëtorin e regjistruar për dy muajt pasues pas regjistrimit
Masa 15	Asistencë mujore prej 130€ për familje

Qeveria e Kosovës miratoi edhe Programin për Rimëkëmbje Ekonomike.⁵ Gjithsej kjo pako kishte të alokuara 222,400,000.00 Euro. Masat e përfshira në këtë pako tentonin që përpos tejkalimit të krizës dhe vështirësive pandemike, gjithashtu të krijonin edhe vende të reja të punës. Mirëpo ndërrimi i kabineteve qeveritare, problematikat shëndetësore dhe vështirësitë e tjera të shkaktuara nga pandemia nuk lejuan që një program i tillë të avansohej dhe të përmbushej. Por ashtu si edhe në pakon paraprake, ashtu edhe në këtë pako është vërejtur mungesa e inkuadrimit të një rimëkëmbjeje e cila anohej nga e ardhmja e gjelbërt.

⁵ Zyra e Kryeministrit, e qasshme në <https://kryeministri.rks-gov.net/?s=programi+i+rimekembjes>, (qasur në janar, 2022)

**Programi për
Rimëkëmbje Ekonomike
(222.4 milionë Euro)**

Përfitimi

Masa 1	Subvencionimi për bizneset aktive dhe “Të vetëpunësuarit”
Masa 2	Mbështetje për sektorin e arsimit për të mundësuar mbarëvajtjen e mësimin
Masa 3	Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimin e aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe rivitalizimin e tyre
Masa 4	Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi
Masa 5	Blerjen e vaksinave dhe materialit për menaxhimin e pandemisë
Masa 6	Sigurim i shtesës mbi pagë për sektorët që kanë barrën kryesore në menaxhimin e pandemisë, për punëtorët e këtyre sektorëve në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërsëdrejti rrezikut të infektimit me COVID-19
Masa 7	Mjete për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Masa 8	Subvencionimi i eksportit për prodhuesit vendor Subvencionimi i stokeve të qumështit dhe produkteve të qumështit Subvencionimi i sektrëve të prekur nga ndalimi i aktiviteteve
Masa 9	Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e pandemisë COVID-19
Masa 10	Rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore Mbulimi i kostos së tarifës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore
Masa 11	Mbështetje për Ndërmarrjet Publike
Masa 12	Mbështetje për realizimin e projektit “Për ambientin dhe gjelbërimin e tokës”

Masa 13	Mbështetje për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për nën-programin Ndërmarrësia
Masa 14	Mbështetje për subvencionimin e tarifës së Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë
Masa 15	Mbështetje të programeve ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal
Masa 16	Mbështetje për skemat pensionale Mbështetje për skemat sociale Mbështetje për personat që kanë humbur vendet e punës si pasojë e pandemisë COVID-19

Edhe Pako e Ringjalljes Ekonomike, pra pako aktuale e ndihmave për tejkalimin e krizës COVID-19 nuk ka në qendër të saj sigurimin e një rimëkëmbje të qëndrueshme dhe afatgjate. Gjithsej shuma e alokuar për këtë pako është 420 milionë Euro, e cila është e shpërndarë në pesë masa kryesore. Ani pse kjo pako ka të përfshirë 100 milionë Euro për investime në infrastrukturë dhe ambient, ku parashihen investime nëpërmjet eficientë dhe energji elektrike, kjo masë ende nuk ka filluar të zbatohet dhe rrjedhimisht nuk ka perspektivë për të zbatuar një rimëkëmbje të gjelbër.

Pako e Ringjalljes Ekonomike (420 milionë Euro)

Përfitimi

Masa 1	Mbështetja për punësim
Masa 2	Mbështetja e Ekonomisë dhe Prodhimit përmes subvencionimit të kredive investive, qasjes në financa, mbështetje të eksportit, investime në TI dhe Inovacion
Masa 3	Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin si pasojë e infektimit me COVID-19, mbështetje për familjet me asistencë sociale dhe pensionistët, reformimi i skemës së asistencës sociale, mbështetje për lehonat e papuna
Masa 4	Mbështetje për Shëndetësinë, Arsimin, Kulturën dhe Sportin, Sigurinë, Mërgatën, Ndërmarrjet Publike
Masa 5	Investime në infrastrukturë dhe ambient

Masa e parë, e quajtur Mbështetja e punësimit, ka në vete shtatë nënmasa. Përmes këtyre nënmasave tentohet sigurimi i vendeve të reja të punës, rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës, skema e granteve për zanatet dhe të tjera. Por kjo masë nuk ka të paraparë krijimin e vendeve të reja të punës të cilat do të fokusoheshin në projekte të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Edhe nga hulumtimet e tjera por edhe nga përvoja e shteteve të tjera dhe praktikat që ato kanë përdorur, është evidentuar që projektet e gjenerimit të energjisë elektrike nga këto burime sigurojnë vende të reja të punës, të qëndrueshme dhe afatgjate. Prandaj pakot e kaluara dhe pako aktuale e ndihmave të Qeverisë së Kosovës kanë anashkaluar parimin e rimëkëmbjes së gjelbër, nga e cila do të mund të arrihej një tejkalim më i shpejtë i krizës, rimëkëmbje më e qëndrueshme, më miqësore me ambientin dhe me një afat më të zgjatur sa i përket sigurimit të vendeve të punës.

Me fjalë të tjera, duke pasur parasysh përmasat e tkurrjes ekonomike dhe kohëzgjatjen e pritshme të saj, Qeveria e Kosovës duhet të ketë udhëzime të qarta se si të prioritizojë shpenzimet dhe ndërhyrjet e saj krahas tejkalimit të pandemisë COVID-19. Në disa raste, si rimëkëmbja e gjelbër dhe nevoja për të reduktuar pabarazinë, është e nevojshme një perspektivë afatgjatë. Ndër të tjera, të tilla si subvencionimet apo mbështetja përmes të hollave për kategori të caktuara, garancitë e kredisë, uljet e taksave për të shmangur falimentimet dhe subvencionet e pagave janë ndërhyrje afatshkurtra për tejkalimin e disa problemeve momentale. Qeveria do të duhej të vendosë këtë ekuilibër, duke synuar në mënyrë paralele ndërhyrjet që kombinojnë ndikimet sociale dhe mjedisore me produktin afatshkurtër dhe gjenerimin e punësimit për një periudhë më afatgjate.

2. Parimet e rimëkëmbjes së gjelbër – mësimet nga vendet tjera



Pandemia do të lë gjurmë edhe pas përfundimit të saj. Pasojat shëndetësore, ekonomike dhe zhvillimore vërehen edhe tani. Por përmirësimi i kësaj gjendjeje do të kërkojë kohë për t'u kthyer në normalitet. Paketë stimuluese që janë implementuar deri më tani janë forcë shtytëse drejt rimëkëmbjes, por këto pako nuk janë të mjaftueshme për krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Po ashtu ndikimi i tyre nuk mund të sigurojë që rimëkëmbja do të jetë e suksesshme në aspekt të zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë në shumë sfera të jetesës. Përveç kapacitetit institucional, i cili kufizon atë që qeveritë mund të bëjnë në të vërtetë, politikë fiskale, politikë të gjelbërta dhe politikë të tjera të përdorura vendosin kufizime sa i përket pakotë stimuluese. Këto kufizime mund të paraqesin problematika në aspektin e ndikimit të pakotë tek qytetarët dhe bizneset. Duke marrë parasysh këto kufizime, kalimi nga menaxhimi ose kujdesi nga fatkeqësitë tek rimëkëmbja afatgjate ekonomike nënkupton ndërrimin e qasjes së qeverisë.

Rimëkëmbja e qëndrueshme kërkon ndërhyrjen e politikave në shumë fusha zhvillimore, e jo vetëm stimulim fiskal për tejkalimin e përkohshëm të krizave dhe vështirësive. Politikë dhe përgjigjet ndaj rimëkëmbjes duhet të jenë të gjera në aspektin e gjithëpërfshirjes, zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe në shumë sfera të tjera. Në këtë mënyrë, paketë e rimëkëmbjes duhet të bazohen në parimin e zhvillimit produktiv. Politikë e zhvillimit produktiv mund të përkufizohen gjerësisht si politika që synojnë të forcojnë strukturën prodhuese të një ekonomie të caktuar kombëtare, përmes krijimit të vendeve të punës, zhvillimit ekonomik, forcimit të stabilitetit dhe arritjes së qëndrueshmërisë afatgjate.

Një ndër aspektet kryesore që duhet të merret parasysh në paketë e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19 është përmirësimi afatgjatë ekonomik dhe fizik i ndryshimeve klimatike dhe angazhimi i vazhdueshëm ndaj arritjes së emetimeve sa më të ulëta të karbonit.⁶ Sipas raporteve dhe matjeve, gjatë pandemisë dhe izolimit si masë ndaj parandalimit të përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë, emetimet ditore globale të gazrave serrë u zvogëluan për 17% në prill të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.⁷ Këto shifra tregojnë se sa shumë shtrihet ndikimi nga aktivitetet e përditshme në aspektin mjedisor të globit. E me rifillimin e aktivitetëve ekonomike dhe kthimin dalëngadalë në normalitet, emetimet e gazrave serrë mund edhe të tejkalojnë shifrat paraprake.

Nevoja për të miratuar politika dhe rimëkëmbje me karbon të ulët dhe në hap pozitiv me ndikimet klimatike është thelbësore. Nëse përmes pakotë financohen dhe shtyhen përpara projekte të gjelbërta, atëherë mund të arrijmë fitorë të dyfishtë, pra duke arritur rimëkëmb-

⁶ IAP, Global Green Recovery After COVID-19: Using scientific advice to ensure social equity, planetary and human health, and economic benefits, e qasshme në https://www.scj.go.jp/ja/int/other/pdf/iap_communique_2020-1.pdf, (qasur në janar, 2022)

⁷ Temporary reduction in daily global CO2 emissions during the COVID-19 forced confinement, e qasshme në <https://www.nature.com/articles/s41558-020-0797-x>, (qasur në janar, 2022)

je ekonomike dhe tejkallim të vështirësive nga pandemia COVID-19, e në anën tjetër duke arritur synimet e emetimit të ulët të gazrave serrë. Promovimi i tranzicionit të energjisë, ku përfshihen projekte të reja të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme do të sjellte mundësi për vende të reja të punës, do të ndihmonte uljen e nivelit të emetimit të gazrave serrë, e gjithashtu do të ndihmonte rimëkëmbjen e cila do të ishte e gjelbërt dhe efikase.

Bashkimi European ka miratuar paraprakisht planin e rimëkëmbjes përmes të cilit synon rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19 dhe mbrojtjen e mjedisit.⁸ Shuma e ndarë për këtë plan është 750 miliardë Euro. Përmes këtij plani parashihet rimëkëmbja ekonomike e cila u dëmtua nga pandemia. Përmes këtij plani është paraparë që shuma më e madhe e mjeteve të ndahet për vendet të cilat prodhojnë më së shumti energji elektrike nga thëngjilli, siç janë Polonia, Gjermania dhe Rumania. Plane të tilla synojnë që të krijojnë kushte më të mira të jetesës, duke mbrojtur mjedisin dhe duke ndihmuar ekonominë në të njejtën kohë.

Në këtë mënyrë, politikbërësit kanë vendosur së zgjidhja më e mirë për rimëkëmbje duhet të jetë e bazuar në aspektet e politikave të gjelbërta. Kjo në mënyrë që edhe tranzicioni energjetik të përshpejtohet dhe të krijohen mundësi për vende të reja të punës, si një formë për tejkallimin e krizës pandemike. Kjo ka nënkuptuar vendosjen e një objektivi minimal prej 37% për shpenzimet për objektivat klimatike nën Institucionin e Rimëkëmbjes dhe Rezistencës.⁹ Ndër të tjera, pakot e gjelbërta të rimëkëmbjes janë në një udhë me Marrëveshjen e Gjelbërt Europiane. Kjo ide për pako të tilla ka efekte disa dimensionale, ku ndër kryesoret janë:

- Përmirësim i zhvillimit ekonomik
- Krijimi i vendeve të reja të gjelbra punës
- Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë



2.1. Parimi i reduktimit të konsumit dhe optimizimit të shpenzimit

Me avansimin e teknologjisë, shtimit të popullësisë dhe kërkesave të shtuara të njerëzimit, është shtuar edhe kërkesa për sasi më të madhe të energjisë elektrike. Për shkak të humbjeve të panevojshme të energjisë elektrike në ndërtesat e banimit, por edhe në vendet e punës dhe

⁸ EU pledges coronavirus recovery plan will not harm climate goals, e qasshme në <https://www.theguardian.com/environment/2020/may/28/eu-pledges-coronavirus-recovery-plan-will-not-harm-climate-goals>, (qasur në janar, 2022)

⁹ A breakdown of EU countries' post-pandemic green spending plans, e qasshme në <https://www.bruegel.org/2021/07/a-breakdown-of-eu-countries-post-pandemic-green-spending-plans/>, (qasur në janar, 2022)

në pajisje teknologjike, është vërejtur që kërkesa për optimizimin e energjisë dhe komoditetin e shfrytëzuesit të këtij burimi ka rëndësi shumë të madhe. Andaj teknikat për reduktimit e konsumit dhe optimizimin e shpenzimit kanë për qëllim ruajtjen e ekuilibrit mes shfrytëzimit sa më të vogël të energjisë elektrike, por në të njëjtën kohë duke ruajtur rehatinë e përdoruesit. Reduktimi i konsumit dhe optimizimi i shpenzimit ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e mjedisit. Kjo për arsye se sa më i ulët konsumi, emetimet e gazrave serrë nga gjenerimi i energjisë elektrike përmes burimeve fosile zvogëlohen. Andaj reduktimi i përdorimit të energjisë elektrike ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e ndikimit të dëmshëm në mjedis e gjithashtu ndihmon proceset jetike siç është procesi i dekarbonizimit.

Bashkimi Europian ka vendosur targete sa i përket reduktimit të konsumit dhe optimizimit të shpenzimit për vitin 2030. Ky target është vendosur në 32.5% krahasuar me vitin 2020. Kjo përkthehet në një konsum të energjisë primare prej jo më shumë se 1,273 Mtoe dhe një konsum përfundimtar të energjisë prej jo më shumë se 956 Mtoe në vitin 2030.¹⁰ Por reduktimet e konsumit duhet të bazohen në secilën veprimtari jetësore, e jo vetëm në aspektin e konsumit të energjisë elektrike.

Përdorimi i sa më pak materiali për arritjen e një produkti, duhet të paraqes parim në secilën fushë të jetesës. Pra për arritjen e produktit të njëjtë, shtimi i efijencës në prodhimin e atij produkti do të paraqiste cikël zingjiror të reduktimit në procese tjera pasuese. Ruajtja e resurseve për shfrytëzim nga gjeneratat aktuale dhe gjeneratat pasuese paraqet një nga parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.

2.2. Parimi i transformimit të infrastrukturës

Kosova është vend me karakteristika jo të mira në aspektin e efijencës së energjisë. Sektori i ndërtimtarisë nuk i kushton shumë rëndësi masave dhe pajisjeve efijente të cilat do të reduktonin shpenzimet e tepërta e në të njëjtën kohë që dëmtojnë mjedisin. Me transformimin e infrastrukturës në sektorin e ndërtimit do të krijoheshin kushte më të mira, rehati e shtuar dhe ulje e nivelit të ndotjes së mjedisit.

Parimi i transformimit të infrastrukturës bazohet në përdorimin e pajisjeve efijente të cilat kryjnë punën e njëjtë me një sasi të reduktuar të energjisë elektrike. Izolimi i mureve, izolimi i kulmit, izolimi i dyshemesë, ndërrimi i dritareve dhe përdorimi i pajisjeve shtëpiake efijente janë disa nga veprimet e transformimit të infrastrukturës që reduktojnë shpenzimet e tepërta të energjisë elektrike. Këto veprime sjellin benefite të cilat janë në të mirë të shfrytëzuesit të tyre por edhe të mjedisit. Këto benefite janë:

- Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë
- Përmirësimi i kualitetit të jetesës
- Zvogëlimi i ndikimit në mjedis
- Kursimi i të hollave

¹⁰ Eurostat, Energy efficiency statistics, e qasshme në https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Energy_saving_statistics&oldid=327342#cite_note-1, (qasur në janar, 2022)

Digjitalizimi është element i rëndësishëm i transformimit të infrastrukturës.¹¹ Kjo pasi që digjitalizimi ofron transformimin e proceseve përmes pajisjeve teknologjike të cilat shpenzojnë më pak energji elektrike për të kryer punën e njejtë. E gjithë kjo sjell efikasitet të shtuar dhe reduktim të ndikimit negativ në mjedis. Ndër të tjera, digjitalizimi ka ndikim të shtuar tek sektori i transportit dhe prodhimit, ku ofron kushte më të mira dhe njëkohësisht ofron modele të reja të biznesit dhe ofrimit të shërbimit.

2.3. Parimi i integritimit

Tranzicioni i energjisë është procesi i reduktimit të emetimeve të gazrave serrë deri në vlerën zero. Tranzicioni i energjisë kërkon reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse fosile si në sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike, ashtu edhe në pajisjet që shfrytëzojnë energji elektrike të tepërt, apo automjetet që funksionojnë përmes djegies së lëndëve djegëse fosile.¹³ Si një proces crucial për të mirën e njerëzimit dhe mjedisit, është edhe proces mjaft i vështirë dhe me një kërkesën për një periudhë kohore afatgjate.

Pakot e rimëkëmbjes së Kosovës nuk kanë përfshirë procesin e tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit. Rrjedhimisht Qeveria e Kosovës nuk ka ndjekur hapat e shteteve të tjera të cilat kanë shfrytëzuar rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19 për të promovuar dhe avansuar këto procese. Përpos ndikimit në mjedis, integrimi i këtyre proceseve në pakot paraprake por edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike do të ndihmonte në krijimin e hapësirave për vende të reja të punës, do të ndihmonte familjet kosovare në tejkalimin e pandemisë dhe do të hapte rrugë për zhvillimin e së ardhmes përmes proceseve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe transformimit të sektorit energjetik të Kosovës.

Përfshirja e tranzicionit të energjisë dhe dekarbonizimit në pakot stimuluuese ndaj pandemisë COVID-19 do të ndihmonte dhe afronte Kosovën në procesin e integritimit europian. Kjo pasi që një nga prioritetet kryesore të Bashkimit Europian është pikërisht tranzicioni i energjisë dhe dekarbonizimi.¹⁴ Prandaj rimëkëmbja e gjelbërt do të sjellte benefite shumë më të mëdha përpos tejkalimit të krizës aktuale, pasi që përmes politikave të tilla do të siguroheshin edhe objektiva të tjerë si mbrojtja e mjedisit, transformimi i sistemit energjetik, afrimi me politikat europiane dhe krijimi i stabilitetit për një periudhë më të gjatë kohore.

¹¹ European Council, Digitalisation for the benefit of the environment: Council approves conclusions, e qasshme në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2020/12/17/digitalisation-for-the-benefit-of-the-environment-council-approves-conclusions/>, (qasur në janar, 2022)

¹² Oko-Institut, Impacts of the digital transformation on the environment and sustainability, e qasshme në https://ec.europa.eu/environment/enveco/resource_efficiency/pdf/studies/issue_paper_digital_transformation_20191220_final.pdf, (qasur në janar, 2022)

¹³ UCL, Decarbonising energy and the energy transition, e qasshme në <https://www.ucl.ac.uk/bartlett/news/2021/apr/decarbonising-energy-and-energy-transition>, (qasur në janar, 2022)


¹⁴ Florence School of Regulation, The European Union Energy Transition: Key priorities for the next five years, e qasshme në <https://fsr.eu.eu/publications/?handle=1814/63553>, (qasur në janar, 2022)

3. Studim krahasimor rastet e Gjermanisë, Norvegjisë, Luksemburgut dhe Bashkimit European

Një rimëkëmbje e gjelbër është çelësi për të siguruar një kthim të qëndrueshëm dhe elastik në rritje dhe zhvillim pas COVID-19. Shembujt global tregojnë se si ndryshimi i klimës dhe temat e tjera të gjelbra mund të jenë qendrore për përgjigjet ndaj COVID-19, në mënyrë që vendet të mund të ndërtohen më mirë.¹⁵ Shtetet europiane si Gjermania, Norvegjia, Luksemburgu, por edhe Bashkimi European në përgjithësi, kanë hartuar, miratuar dhe implementuar pako të rimëkëmbjes nga COVID-19 duke u bazuar në parimet e politikave të gjelbërta. Gjermania si një nga shtetet më të zhvilluara ekonomisht në Europë tashmë ka miratuar disa pako të rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19. Këto pako ashtu si edhe në vendet tjera, kanë për qëllim avansimin dhe tejkalimin e krizës pandemike. Plani i rimëkëmbjes që u miratua nga ana e Këshillit të Komisionit European më 13 korrik 2021,¹⁶ është një nga pakot më ambicioze në Europë.

Nga kjo pako e rimëkëmbjes së shtetit gjerman së paku 42% do të mbështesë objektivat e klimës dhe të paktën 52% e pakos do të nxisë tranzicionin dixhital.¹⁷ Ndarjet e tilla për një pako e cila synon tejkalimin e krizës janë ambicioze në aspektin e arritjes së objektivave për ndryshimet klimatike, burimet e ripërtëritshme dhe avansimin tutje të agjendës së gjelbër. Andaj kjo pako përpos këtyre synimeve, do të krijoj mundësi të reja për vende të reja të punës.

Pako e rimëkëmbjes së Gjermanisë



¹⁵ ADB, Responses to Post-COVID-19 Green Recovery, e qasshme në <https://www.adb.org/sites/default/files/related/185636/responses-post-covid-19-green-recovery.pdf>, (qasur në janar, 2022)

¹⁶ European Commission, Germany's recovery and resilience plan, e qasshme në https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/recovery-coronavirus/recovery-and-resilience-facility/germanys-recovery-and-resilience-plan_en, (qasur në janar, 2022)

¹⁷ Ibid.

Norvegjia është një tjetër shtet europian që ka hartuar pako të zgjidhjes së vështirësive duke u bazuar në politika të gjelbërta. Norvegjia thuhet se është shtet i cili nuk emeton fare gazra serrë, pasi që 98% e prodhimit të energjisë elektrike në këtë shtet bazohet në hidrocentrale dhe centrale me erë.¹⁸ Por një gjë e tillë nuk e ka penguar që në pakon e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19, të integrojë masa për shtimin e gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, pasi që një gjë e tillë siguron vende të reja pune, qëndrueshmëri afatgjate dhe të ardhme më të pastër.

Norvegjia ka hartuar pakon prej 370,000,000 Eurove për të ofruar mbështetje për industrinë e gjelbërta.¹⁹ Disa nga fushat kryesore në të cilat fokusohet kjo pako janë:

- Hidrogjeni (Përpunimi, infrastruktura, përdorimi)
- Teknologjia e baterive
- Centralet me erë
- Transporti me emetime të ulëta

Pako e tillë shton konkurrencën, ndihmon në zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë, krijon vende të reja pune dhe ndihmon qytetarët dhe bizneset e Norvegjisë në tejkalimin më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Qeveria e Luksemburgut ka vendosur që paketat stimuluuese t'i hartojë duke u bazuar në politikat e gjelbërta. Prandaj duke synuar që të ndihmojë qytetarët, por në të njëjtën kohë të avansojë procesin e dekarbonizimit dhe tranzicionit energjetik, Qeveria e Luksemburgut ka vendosur që të ofrojë mbështetje për eficientësinë e energjisë dhe makinat elektrike. Përfitimet variojnë deri në 30,000 Euro për shtëpi dhe 8,000 Euro për makina elektrike.²⁰ Subvencionimi i tillë përmirëson kualitetin e jetesës dhe krijon hapësira të mëdha për një të ardhme më të pastër.

Fondi i rimëkëmbjes së Bashkimit Europian ka të parapara 500,000,000,000 Euro grante dhe 250,000,000,000 Euro kredi për shtetet anëtare të saj.²¹ Këto fonde janë të synuara të ndihmojnë procesin e rimëkëmbjes, e në të njëjtën kohë investime në tranzicionin e energjisë dhe fonde për shtetet të cilat janë të varura nga qymyri. Pra përpos përrimit të rimëkëmbjes, Bashkimi Europian po shfrytëzon mundësinë e rikthimit në normalitet duke ndihmuar procese jetike të gjelbërta, të cilat janë në të mirë të mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

¹⁸ Energy Facts Norway, Energy Production, e qasshme në <https://energifaktanorge.no/en/norsk-energiforsyning/kraftproduksjon/>, (qasur në janar, 2022)

¹⁹ Life in Norway, Norway Proposes NOK 3.6bn Green Investment Package, e qasshme në <https://www.lifeinnorway.net/norway-proposes-nok-3-6-billion-green-investment-package/>, (qasur në janar, 2022)

²⁰ RTL, Climate action: "It's now!" - green affordable housing in Luxembourg, e qasshme në <https://today.rtl.lu/news/luxembourg/a/1526282.html>, (qasur në janar, 2022)

²¹ ADB, Responses to Post-COVID-19 Green Recovery, e qasshme në <https://www.adb.org/sites/default/files/related/185636/responses-post-covid-19-green-recovery.pdf>, (qasur në janar, 2022)

Grantet nga ana e Bashkimit European parashihet të ndahen në disa kategori më kryesore. Këto kategori janë:²²

- 560,000,000,000 Euro do të ndahen për tranzicionin e gjelbërt dhe digjitalizimin e ekonomisë
- 55,000,000,000 Euro do të ndahen në aspektin socio-ekonomik
- 15,000,000,000 Euro do të shpërndahen në sektroin e agrokulturës

Synimi i alokimit të mjeteve të lartëpërmendura është arritja e një të ardhme më të mirë, ku në fokus është ringritja ekonomike dhe prioritizimi i të ardhmes së pastër.

Fokusi dhe drejtimi i pakove nga tranzicioni energjetik, dekarbonizimi dhe mjedisi i pastër janë udhërrëfyes të qartë të rrugës e cila duhet ndjekur për të arritur rimëkëmbje të suksesshme dhe të qëndrueshme. Praktikrat e tilla, të cilat tashmë po tregojnë sukseset e tyre, duhet të jenë bazë e cila duhet të merret parasysh edhe nga Qeveria e Kosovës. Paket e ardhshme të rimëkëmbjes duhet të përfshijnë më shumë rimëkëmbje sesa shpëtim të gjendjes paraprake të ekonomisë. Është me rëndësi të madhe të kemi një pozicionim të fortë të Qeverisë së Kosovës në një agjendë reformash që kalon nga një ekonomi e errët në një ekonomi të gjelbër.

²² European Commission, Europe's moment: Repair and prepare for the next generation, e qasshme në https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_940, (qasur në janar, 2022)

4. Kornizë e opsioneve politike për rimëkëmbje të gjelbër



Qeveria e Kosovës duhet të ndryshojë rrjedhën e Pakos së Ringjalljes Ekonomike por edhe pakove të cilat do të pasojnë më vonë. Është koha që Kosova të ridrejtojë financimin nga investimet në sektorin e transportit, në investime në sektorin e shëndetësisë dhe një angazhim serioz për të mundësuar tranzicionin e sektorit të energjisë. Drejtimi i politikave në këto sektor dhe rishikimi i mundësive për një rimëkëmbje të gjelbër do të sigurojë qasje më të mirë nga këndelljes nga pandemia COVID-19 dhe do të ofrojë mundësi të tejkalimit më të shpejtë të krizës.

Institucionet Ndërkombëtare Financiare kanë ndihmuar në mbështetjen dhe sigurimin e fondeve për implementimin e shumë projekteve por edhe në tejkalimin e vështirësive të shfaqura nga pandemia. Institucionet e tilla si Banka Evropiane e Investimeve, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës dhe Banka Botërore²³ kanë ofruar dhe ende ofrojnë fonde dhe grante të cilat ndihmojnë shtyrjen përpara të proceseve të rëndësishme ekonomike, shëndetësore dhe proceseve të cilat kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm.

Disa nga opsionet përmes të cilave mund të arrihet një rimëkëmbje e gjelbërt janë:

- Sigurimi i vendeve të reja të punës përmes tranzicionit energjetik
- Forcimi i mbrojtjes së biodiversitetit
- Reformimi i transportit
- Shtimi i masave për eficiencën e energjisë
- Digjitalizimi
- Masat për tregun dhe integrimin e tregut

Politikat e lartpërmendura janë vetëm disa nga masat të cilat Qeveria e Kosovës mund të integronë në pakot e kaluara dhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, përmes të cilave do të kishim qasje më të mirë dhe më zhvillimore nga pandemisë COVID-19.

Në përgjigje të trazirave të rëndësishme ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19, Qeveria e Kosovës duhet të stimulojë rritjen ekonomike në një mënyrë të qëndrueshme, protektive dhe afatgjate. Në këtë mënyrë do të paraqesim disa masa konkrete të cilat do të kontribuonin në arritjen e qëllimeve të tilla.

²³ INDEP, Rimëkëmbja është e Gjelbër: Përfitimi nga Eficiencia e Energjisë për Sektorin Privat, e qasshme në https://indep.info/wp-content/uploads/2021/03/INDED_Rimekembja-eshte-e-gjelber_shqip.pdf, (qasur në janar, 2022)

Opsionet e politikave

Benefitet

Gjenerimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

1. Krijimi i vendeve të punës
2. Tranzicioni i energjisë dhe dekarbonizimi
3. Ngritja e investimeve
4. Përafrimi me politikat europiane dhe integrimi në Bashkimin European
5. Inovacion teknologjik

Masat e eficiencës së energjisë

1. Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë
2. Përmirësim i kualitetit të jetesës
3. Zvogëlim i ndikimit negativ në mjedis
4. Krijimi i vendeve të punës
5. Përmirësimi i të ardhurave të familjeve
6. Nxiti zhvillimin rajonal
7. Përshejton përfitimet e reduktimit të karbonit dhe zvogëlon kërkesën për energji

Reformimi i transportit

1. Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë
2. Digjitalizimi i transportit
3. Dekarbonizimi

4.1. Masat për eficiencën e energjisë

Eficienca e energjisë nënkupton shfrytëzimin e sa më pak sasi të energjisë elektrike për të kryer punën e njejtë. Nëpërmjet këtij procesi reduktojmë faturat dhe zvogëlojmë ndotjen. Shumë familje dhe biznese përdorin sasi më shumë sesa ju duhet të energjisë elektrike. Praktika e tillë duhet të ndryshohet dhe masat duhet të shtohen në aspektin e reduktimit të sasisë së tepërt të energjisë elektrike që përdorim.

Duke e ditur se eficienca e energjisë do të kontribuonte në arritjen e rimëkëmbje së gjelbër, Qeveria e Kosovës do të duhej të aplikonte masa dhe politika të cilat do të shërbenin në këtë drejtim. Disa nga masat apo politikat që do të adaptonin më tutje eficiencën e energjisë në shoqërinë kosovare janë:

- Standardet e pajisjeve
- Rregullore të ndërtimit
- Taksa ndaj CO₂
- Trajnimi dhe edukimi

Të gjitha këto masa do të ndihmonin në kuptimin më të qartë, aplikimin dhe arritjen e reduktimit të reduktimit të shpenzimeve të panevojshme të energjisë elektrike.

Standardet e pajisjeve

Qeveria e Kosovës ka mundësinë e inkuadrimin të masave në kuadër të pakove stimuluese, të cilat subvencionojnë një pjesë të pajisjeve efçiente që vendosen nëpër shtëpi nga familjet kosovare. Mundësitë e tilla përafrohen me rimëkëmbjen e gjelbërt dhe përkojnë me direktivat europiane. Nëpërmjet politikave të tilla, Qeveria ndihmon qytetarin, mjedisin dhe procesin e dekarbonizimit.

Rregullore të ndërrimit

Të aplikohen masat e efçiensës së energjisë në ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese. Me vendosjen e rregullave të cilat përcaktojnë qartë caqet e efçiensës në ndërtesa dhe me zbatimin e tyre, do të kontribuojmë në një të ardhme e cila do të jetë më e pastër dhe më e qëndrueshme. Ani pse në Republikën e Kosovës është në fuqi Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërrim, ky ligj nuk zbatohet me përpikmëri. Kjo pasi që ligji thekson që masat e efçiensës së energjisë duhet të përmbushen në mënyrë që objekti të pajiset me çertifikatën e përdorimit, e një gjë e tillë nuk po merret parasysh tash e disa kohë.

Taksa ndaj CO₂

Taksa ndaj CO₂ funksionon në parimin që ndotësi paguan, duke detyruar prodhuesit dhe konsumatorët të paguajnë taksa për çdo ton të emetimeve të CO₂. Taksa ka efektin e zvogëlimit të ndikimit në mjedis dhe të penalizimit të ndotësve të mëdhenj. Përmes aplikimit të një politike të tillë do të ndihmohej ngritja e nivelit të efçiensës së energjisë, transformimi i prodhimit dhe inkuadrimi i mëtutjeshëm i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në vendin tonë.

Qeveria e Kosovës ka stanguar në aplikimin e masave të cilat do të stimulojnë ngritjen ekonomike, e në të njëjtën kohë do të kontribuonin tranzicionin energjetik dhe dekarbonizimin. Janë një mori masash të cilat Qeveria e Kosovës do të mund t'i aplikonte, e që do të arrinte përfitime në të dy drejtimet e lartpërmendura. Disa nga masat të cilat do të mund të mirreshin nga ana e Qeverisë së Kosovës, e të cilat qëndrojnë afër me masat e efçiensës së energjisë janë:

- Subvencionimi i kredive të gjelbërta
- Subvencionimi i gjysmës së shumës të shpenzuar për ngritjen e efçiensës së energjisë (izolimi i mureve, izolimi i çatisë, izolimi i dyshemesë, ndërrimi i dritareve dhe dyerve, ndërrimi i pajisjeve shtëpiake)
- Subvencionimi i makinave elektrike
- Ndërrimi i centrale të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme

4.2. Transformimi i gjenerimit të energjisë përmes rimëkëmbjes

Ndërrimi i centraleve të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme është një nga pikat kyçe e cila do të duhej të integrohej në paket paraprake por edhe në Pa-

kon e Ringjalljes Ekonomike. Duke e ditur se Kosova është vend i cili gjenerimin e energjisë elektrike e ka të bazuar në thëngjill, pandemia COVID-19 dhe rikuperimi nga kjo pandemi do të duhej të paraqiste mundësi edhe të transformimit të gjenerimit. Kjo në mënyrë të rimëkëmbjes pasi që krijohen vende të reja të punës dhe mundësi të reja për investime nga jashtë, e në anën tjetër rimëkëmbje ekonomike nga pandemia.

Nëse qeveritë kufizojnë ngrohjen globale në 1.5 gradë Celsius mbi nivelet paraindustriale, sektori i energjisë së burimeve të ripërtëritshme mund të rritet në 38 milionë vende pune deri në vitin 2030 dhe 43 milionë vende pune deri në vitin 2050.²⁴ Duke e parë potencialin e Kosovës për gjenerim të energjisë elektrike nga dielli dhe era, atëherë edhe potenciali për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik është i lartë. Mundësi të tilla do të duhej të përfshiheshin në pakot e rimëkëmbjes të miratuara nga Qeveria e Kosovës.

Kosova burim kryesor të energjisë e ka linjitin. 86.49% e kapacitetit operativ të energjisë elektrike totale gjenerohet nga ky burim, ndërsa pjesa tjetër nga hidrocentralet, centralet me erë dhe centralet solare.²⁵ Basenet kryesore të linjtit janë: Baseni i Kosovës, Baseni i Dukagjinit dhe Baseni i Drenicës. Si lëndë djegëse, ndotja që i shkaktohet mjedisit me djegien e tij, është shumë e madhe dhe shumë e dëmshme për të gjithë organizmat e gjallë. Viteve të fundit ka filluar edhe inkuadrimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë në tregun energjetik tonin, por ende nuk janë arritur caqet e synuara.

Prandaj duke synuar integrimin europian, zhvillimin e vendit, krijimin e vendeve të punës dhe tranzicionin energjetik, Kosova medoemos do të duhet të transformojë sektorin aktual të energjisë. Transformimi në energji të gjelbërt është e ardhmja, e cila është e paevitueshme. Në këtë mënyrë, inkurajojmë Qeverinë e Kosovës që të marrë parasysh opsionet e gjelbërta të rimëkëmbjes, për një ballafaqim më të lehtë me krizën pandemike dhe zhvillimin afatgjatë të vendit.

4.3. Masat për tregun dhe integrimin e tregut

Tregu paraqet bashkimin e interkonektorëve dhe më pastaj tregtimin e energjisë përmes tyre.²⁶ Krijimi i një tregu të përbashkët energjetik është i favorshëm për secilin shtet. Kjo pasi që siguron rrjedhje më të sigurtë të energjisë, alokim më të lehtë të kapaciteteve, tregtim më të shpejtë dhe më të lirë, si dhe siguron çmim më të përbalueshëm për konsumatorët. Prandaj, Kosova dhe Shqipëria duhet të synojnë krijimin e një tregu të përbashkët i cili siguron furnizim dhe siguri më të madhe për të dy vendet.

²⁴ Reuters, Renewable energy jobs grew globally in 2020 despite COVID-19 crisis, e qasshme në <https://www.reuters.com/business/cop/renewable-energy-jobs-grew-globally-2020-despite-covid-19-crisis-2021-10-21/>, (qasur në janar, 2022)

²⁵ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2020, e qasshme në https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202020_ZRRE_shqip.pdf, (qasur në janar, 2022)

²⁶ INDEP, Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri – Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen, e qasshme në <https://indep.info/bashkimi-energjetik-kosove-shqiperi-sfidat-dhe-mundesite-per-te-ardhmen/>, (qasur në janar, 2022)

Disa nga masat që do të duhej të përfshiheshin në pakot e rimëkëmbjes, e të cilat përafrohen me tregun energjetik janë:

- Investimet në rrjetin energjetik
- Organizimi i ankandëve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme

Ndër të tjera, pakot paraprake dhe pako aktuale, përmes integritit të këtyre masave do të kontribuonin në përshpejtimin e procesit të bashkimit me Shqipërinë në aspektin energjetik. Tregu i përbashkët synon një laramani të produkteve që më pastaj të ekzistojë konkurrenca dhe të ketë mundësi konsumatori që të zgjedh atë që përkon më së miri me interesat e tij. Konkurrenca sjell transparencë më të madhe, mundësi zgjedhjeje, operim më të mirë të tregut, si dhe siguri për furnizim me energji elektrike. Me integrimin tutje të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, do të krijohet më shumë laramani dhe më shumë opsione për konsumatorët. Rrjedhimisht pakoja do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes aktuale në sektorin e energjisë, e më vonë edhe në benefite tjera për konsumatorët.

Përfundime

- Pandemia COVID-19 ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në Kosovë. Paketat stimuluese që janë implementuar dhe që po implementohen aktualisht nuk kanë pasur qasjen e duhur. Kjo pasi që synimi kryesor ka qenë tejkalimi i krizës momentale e jo krijimi i një stabiliteti dhe ngritje e ekonomisë për një periudhë afatgjatë. Një qasje e tillë është e gabuar dhe rrjedhimisht jo efektive për ndihmën ndaj qytetarëve të Kosovës.
- Rimëkëmbja e gjelbër nuk ka qenë bazë e rimëkëmbjes në Kosovë. Kanë munguar dhe tashmë edhe në Paketën e Ringjalljes Ekonomike po mungojnë masa të cilat ndërlidhen me krijimin e resurseve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Zingjiri i krijimit të këtyre resurseve ndërlidhet me disa faktorë shumë të rëndësishëm, siç janë krijimi i vendeve të reja të punës, tejkalimi i krizës, zhvillimi ekonomik dhe shtyrja përpara e procesit të tranzicionit energjetik. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një zhvendosje serioze drejt një të ardhme të gjelbër dhe të qëndrueshme përmes hartimit dhe planit të Paketës Ekonomike të zgjeruar duke përfshirë mekanizmat e stimulimit të gjelbër.
- Qeveria e Kosovës nuk ka ndjekur shembujt e paketave stimuluese në botë. Shembujt e Gjermanisë, Norvegjisë, Luksemburgut dhe Bashkimit Europian janë pikë referuese kryesore e asaj që rimëkëmbja e gjelbër është rimëkëmbja e duhur. Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet seriozisht për një rimëkëmbje të gjelbër dhe të alokojë fonde për këtë rimëkëmbje, duke lehtësuar më shumë investime të sektorit privat në energjinë e ripërtëritshme, veçanërisht për sistemet diellore të instalimit të paneleve për familjet dhe bizneset. Një politikë e tillë do të lejojë Kosovën që në përputhje me politikën dhe rregulloret e BE-së, të lejojë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe një të ardhme miqësore nga ana sociale dhe mjedisore.
- Shtetet europiane po arrijnë sukses në aspektin e tejkalimit të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 përmes paketave që bazohen në mbështetje të gjelbër. Subvencionimi i masave për shtimin e efikasitetit të energjisë, subvencionimi i makinave elektrike dhe mbështetjet e tjera në aspektin e politikave të gjelbërta, sjellin benefite të shumta për të ardhmen. Kështu që duke u bazuar në politikën e vendeve të tjera dhe në suksesin e tyre, atëherë edhe Kosova do të duhej të ndiqte në paketat e kaluara një metodologji të tillë.

- Qeveria e Kosovës nuk po ndërmerri masa për transformimin e sektorit të energjisë. Mundësia e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19 përmes rimëkëmbjes së gjelbër është adekuate dhe profitabile. Përpos diversifikimit të burimeve të energjisë dhe shtimit të tyre, do të arrihej zhvillim ekonomik më i pastër dhe me perspektivë më të madhe se sa që është tani. Ky punim ka shpërfaqur shembuj tek të cilat Qeveria e Kosovës do të mund të bazohet dhe përmes tyre të hartojë pakot pasuese të cilat sigurisht se duhet të fokusohen tek rimëkëmbja e gjelbër, e jo vetëm në politikat e tejkalimit të krizës ekonomike aktuale.

Rekomandime

1. Qeveria e Kosovës të hartoj pako stimuluese me përfshirjen e politikave të gjelbërta. Qeveria duhet të prioritzojë mbështetjen për shtimin e gjeneruesve të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Këto projekte duhet të sigurohet që të ofrojnë vende të reja pune, diversifikim të gjenerimit, mbrojtje të mjedisit dhe tranzicion energjetik. Stimujt në pakot e ardhshme të jenë profitabile edhe për vendin por edhe për investuesit, në mënyrë që të shpejtohet rimëkëmbja dhe të arrihen objektivat e përcaktuara nga direktivat europiane.
2. Qeveria e Kosovës të largoj taksat e pajisjeve të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Heqja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar e cila është 18% për këto pajisje, do të stimulojë investitorët që të investojnë në projekte të reja në Kosovë. Një politikë e tillë ndihmon tranzicionin energjetik, hap vende të reja pune dhe mundëson shpejtimin e procesit të dekarbonizimit.
3. Qeveria e Kosovës të alokoj mjete të konsiderueshme për ndërtimin e centraleve me erë dhe centraleve fotovoltaike. Mundësia për gjenerim të energjisë elektrike nga këto burime është e madhe, andaj edhe investimet dhe mjetet nga ana e Qeverisë duhet të fokusohen në projekte të tilla. Sigurimi i vendeve të reja të punës, shtimi i kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike, siguria energjetike dhe tranzicioni energjetik janë vetëm disa nga benefitet e projekteve të tilla.
4. Të ndiqen shembujt e shteteve që kanë aplikuar pakot stimuluese në parim me politikat e gjelbërta. Shembujt e Gjermanisë, Norvegjisë, Luksemburgut dhe Bashkimit Europian kontribuojnë në hartimin e një pako të mirëfilltë, gjithëpërfshirëse dhe zhvillimore kundrejt tejkalimit të krizës nga pandemia COVID-19. Qeveria e Kosovës duhet të marrë praktika të mira, të cilat janë treguar të suksesshme në vendet e tjera, në mënyrë që të sigurojë që pakot e ardhshme të jenë me ndikim të madhë në aspektin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit.
5. Të shtohen fushatat e vetëdijësimit në lidhje me teknologjinë e vetëprodhimit nga energjia solare dhe për masat e efijencës së energjisë. Ekziston një mungesë e madhe e vetëdijes dhe informacionit për mundësitë e burimeve të ripërtëritshme për vetë-konsumator në Kosovë. Kështu, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që konsumatorët të jenë të informuar mirë për të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe për kursimet e energjisë elektrike për pronarët e shtëpive. Një kampanjë e mirëfilltë do të siguronte informacione të mjaftueshme për konsumatorët të cilët hezitojnë ndërmarrjen e hapave që lidhen me këto teknologji.

6. Qeveria e Kosovës të fillojë bisedimet me institucionet si Banka Evropiane e Investimeve, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës dhe Banka Botërore për sigurimin e kredive për rimëkëmbje të gjelbër. Janë pikërisht këto institucione që sigurojnë fonde për investime në projekte të gjelbërta. Andaj negociatat para hartimit të pakos do të siguronin një pako të mirë strukturuar dhe të sigurt në aspektin e financimit dhe implementimit të saj.
7. Qeveria e Kosovës të krijojë një mekanizëm elektronik i cili monitoron implementimin e masave të pakove të rimëkëmbjes. Ky mekanizëm do të shërbente si një platformë për ndjekjen e progresit, rritjen e komunikimit midis palëve të interesuara dhe planifikimin e politikave bazuar në nivelin e zbatimit të synimeve. Gjithashtu përmes këtij mekanizmi rritet niveli i transparencës dhe llogaridhënies.
8. Qeveria të krijojë një grup të përbashkët, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të bizneseve dhe shoqërisë civile për hartimin e pakove të ardhshme. Gjithpërfshirja në procese të tilla nënkupton hartim të një pako më të mirë, më profitabile dhe më të suksesshme në terma ekonomik. Idetë dhe përvojat janë shumë të rëndësishme në tejkalimin e krizës aktuale, andaj përgaditja për përmirësimin e së ardhmes duhet të bazohet në opinionet e të gjithë akterëve relevant.
9. Të gjitha pakot e rradhës të vendosen në konsultim publik para miratimit të tyre. Konsultimet publike janë e drejt e gjithsecilit, kështu që përfshirja e tyre në pako që dedikohen për qytetarët është mjaft e rëndësishme. Një proces i tillë shton sigurinë e suksesit të pakos, përfshirjes së shtuar të sektorëve të prekur nga pandemia dhe shpejtim të procesit të rimëkëmbjes.
10. Të bëhet vlerësimi i masave të pakove paraprahe dhe masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Vlerësimi i ndikimit të këtyre masave ndihmon në hartimin e masave të pakove të ardhshme, në mënyrë që të mos ketë dështime në mbështetje për qytetarët. Vendosja e standardeve për secilën masë përmes procesit të vlerësimit të tyre ndihmon në arritjen e tejkalimit të vështirësive të shkaktuara nga pandemia COVID-19.







“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë